



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.54/2021

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami kryetar, Erdogan Haxhibeqiri dhe Fejzullah Rexhepi anëtarë të kolegjit, lidhur me ankesën e Xh. S., anëtare e Komisionit të Vendotimit QV2614/01D, nga subjekti zgjedhor “Lëvizja Vetëvendosje”, paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A.nr.630/2021, të datës 20.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 23.10.2021, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa e Xh. S., anëtare e Komisionit zgjedhor në Vendvotimin QV2614/01D, nga subjekti zgjedhor “Lëvizja Vetëvendosje”, e paraqitur kundër pikës III, të vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A.nr.630/2021, të datës 20.10.2021.
- II. Pika I dhe II, e vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A.nr.630/2021, e datës 20.10.2021, mbesin të pashqyrtuara.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A.nr.630/2021, të datës 20.10.2021, në pikën I, të dispozitivit, pranohen të bazuara ankesat A.nr.630/2021, e datës 17.10.2021, e parashtruara nga subjekti politik “Lidhja Demokratike e Kosovës” dhe ankesa me

numër A.nr.658/2021, e datës 18.10.2021, e parashtruar nga "BIRN", dhe "Internews Kosova", ndërsa Subjektit Politik "Lëvizja Vetëvendosje", i shqiptohet gjobë në lartësi prej 1,000.00 euro (një mijë euro), në emër të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike - Thyerja e heshtjes zgjedhore. Në pikën II, të dispozitivit, detyrohet subjekti politik "Lëvizja Vetëvendosje", që gjobën e shqiptuar si në pikën I, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguajë në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë. Në pikën III, të dispozitivit të vendimit të PZAP-së, i ndalohet Xh. S., me numër të letërnjoftimit ..., nga subjekti politik "Lëvizja Vetëvendosje", me seli në Prishtinë, pjesëmarrja në zgjedhje, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhore për periudhën kohore, në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, nga dita e marrjes së vendimit.

Kundër vendimit të lartpërmendur, konkretisht pikës III, Xh. S., me kohë ka paraqitur ankesë për konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, duke i propozuar Gjykatës Supreme që të aprovohet si e bazuar kjo ankesë, dhe të anulohet vendimi i lartpërmendur i PZAP-së, me numër A.nr.630/2021, i datës 20.10.2021, duke i hequr ndalesën e shqiptuar.

PZAP, në përgjigje në ankesë të paraqitur kundër vendimit me A.nr.630/2021, të datës 20.10.2021, i propozon Gjykatës Supreme që ankesa e Xh. S. të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore dhe të përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa e Xh. S., e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), A.nr.630/2021, të datës 20.10.2021, është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se me datë 17.10.2021, PZAP, ka pranuar ankesat Anr.630/2021, të datës 17.10.2021, e parashtruar nga Subjekti politik "Lidhja Demokratike e Kosovës", dhe A.nr.658/2021, të datës 18.10.2021, e parashtruar nga "BIRN" dhe "Internews Kosova", kundër Subjektit Politik "Lëvizja Vetëvendosje", në të cilat pretendohet se komisionerja Xh. S., nga subjekti politik "Lëvizja Vetëvendosje", e ka bërë postimin dhe

shpërndarjen e materialeve zgjedhore në rrjetin social në "Facebook", ku ka postuar një fotografi duke votuar dhe duke i ftuar qytetarët që të dalin dhe të votojnë numrin 144. Gjithashtu parashtuesit e ankesës "BIRN" dhe "Internews Kosova", kanë theksuar se njëjta është komisionere në Gjilan, përfaqësuese e subjektit politik "Lëvizja Vetëvendosje", me këtë rast paraqitësit e ankesës theksojnë se është bërë shkelje e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe si provë kanë bashkangjitur fotografi të printuar në cilësi të provave materiale.

Paneli, pas vlerësimit të pretendimeve në ankesa A.nr.630/12021, të datës 17.10.2021, dhe Anr.658/2021, të datës 18.10.2021, të cilat për nga përmbajtja janë të njëjta dhe të gjitha ankesat janë paraqitur kundër subjektit të njëjtë politik "Lëvizja Vetëvendosje", Paneli bazuar në nenin 8, paragrafi 3, të Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-së, i ka bashkuar ankesat në një me numër A.nr.630/2021. Nga shkresat e lëndës shihet se subjekti politik "Lëvizja Vetëvendosje", përkatësisht komisionerja e këtij subjekti Xh. S., gjatë ditës së votimit në rrjetin e saj social "Facebook", ka bërë fushatë zgjedhore dhe ka udhëzuar që të votohet subjekti politik "Lëvizja Vetëvendosje", me numër 144, të apostrofuat në ankesë ku me këtë veprim ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Andaj Paneli, duke iu referuar të cekurave më lart dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së, konstaton se subjekti politik "Lëvizja Vetëvendosje" përkatësisht komisionerja e këtij subjekti Xh. S., është përgjegjëse për veprimet e saj, pasi që me veprimin e lartcekur ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b, të LZP-së.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në vendimin e PZAP, pasi që vendimi i kundërshtuara nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës material.

Gjykata Supreme, e pranon në tërësi gjendjen faktike të konstatuar nga PZAP, pasi që me provat që gjenden në shkresat e lëndës, konstatohet në mënyrë të plotë dhe të besueshme gjendja faktike e konstatuar nga PZAP. Nga provat në shkresat e lëndës dhe fotot e ofruara si provë konfirmohet përmbajtja e shkeljes së konsumuar nga Xh. S., pasi që me veprimin e lartcekur ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b, të LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të

votimit ku thuhet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohe bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

Gjykata Supreme e Kosovës e aprovon qëndrimin e PZAP-së, pasi që konstaton se, konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-së, Nr.02/2015, ka ndërmarr hetim lidhur me pretendimet e paraqitësve të ankesave, dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara, për faktin se në llogarinë e “Facebook-ut”, të komisioneres së subjektit politik "Lëvizja Vetëvendosje", Xh. S., ashtu siç pretendojnë paraqitësit e ankesës, në ditën e votimit kanë hasur në fotografi të postuar me të cilën bënë thirrje që të votohet subjekti i caktuar, ku me këtë veprim ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore. Pretendimet e subjektit politik "Lëvizja Vetëvendosje", se nuk vërtetohet se Xh. S.F, është komisionere e atij subjekti politik, Paneli i vlerësoi si të pa bazuara për arsye se nga fotoja e paraqitur në ankesë shihet se e njëjta bart ID, me të cilën identifikohet si komisionere e subjektit politik, dhe e njëjta bënë thirrje që të votohet numri 144. Këtë fakt PZAP, e vërtetoi duke i bërë kërkesë në KQZ, për verifikimin e komisionerës në fjalë dhe nga përgjigjja e dhënë, rezultoi fakti se e njëjta është komisionere e subjektit politik "Lëvizja Vetëvendosje", në Komunën e Gjilanit.

Gjykata Supreme nuk i ka pranuar as pretendimet se postimet në rrjete sociale janë të natyrës personale dhe nuk kanë cenuar heshtjen zgjedhore. Masat e shqiptuara janë në përputhje me rrethanat e vlerësuara e veçanërisht janë ekuivalente më shkeljen e konsumuar, prandaj pretendimet kësaj natyre janë vlerësuar si të pathemelta.

Kjo gjykate konstaton se paneli, me rastin e vendosjes si në pikën -III-, të dispozitivit të këtij vendimi, ka zbatuar drejtë dispozitën ligjore të nenit 120 par.3, pika d, të LZP-së, në të cilin parashihet se: “Në rast se ka ndodhur një shkelje e këtij ligji ose rregullave zgjedhore e cila minon integritetin e zgjedhjeve, PZAP mund të ndalojë një individ të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, si kandidat apo edhe si pjesë administrative ndonjë organi zgjedhor, për një periudhë kohore që nuk u kalon gjashtë (6) vite”. Në rastin konkret është provuar shkelja dhe është shqiptuar masa në përputhje me ligjin e zbatueshëm.

Ky qëndrim i PZAP-së, u miratua për faktin se , ankuesja me pretendimet ankimore nuk ka arritur që të vë në dyshim gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë nga ana e organit, vendimi i të cilit është kontestuar, prandaj u refuzuan si të pathemelta pretendimet ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike.

Për arsyet e paraqitura më lartë, në pajtim me dispozitën e nenit 118 pika 4 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.54/2021, me datë 23.10.2021

Kryetar i kolegjit

Beshir Islami